

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6932
E martë, 27 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

Shefi i ri i EULEX-it merr detyrën



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

LIROHEN TRE POLICËT E KOSOVËS QË MBAHESHIN NË SERBI

FAQE 4-5

AKTUALE



**NATO-ja THOTË SE REBELIMI I
WAGNERIT TREGOI GABIMIN E
MOSKËS PËR SULM NDAJ KIEVIT** F. 2

**NAMAZI I KURBAN BAJRAMIT FALET
TË MËRKURËN NË ORËN 05:38** F. 6

**IKD-JA: NDRYSHIMI I
RREGULLORES PËR EMËRIMIN E
KRYEPROKURORIT TË SHTETIT DHE
KRYEPROKURORËVE TË PROKURORIVE
TË KALOJË PËRMES PROCESIT TË
KONSULTIMIT PUBLIK** F. 5

EKONOMI



**MBI 21 000 FAMILJE PËRFITUAN
NGA SKEMA E NDIHMËS SOCIALE
NË MUAJIN MAJ** F. 8

**BANKA EVROPIANE PËR
INVESTIME, E GATSHME TA
MBËSHITESË FONDIN SOVRAN** F. 8

SPORT



**GASHI LË GJERMANINË, KONFIRMON
RIKTHIMIN NË FUTBOLLIN E KOSOVËS**

F. 12



Tre zyrtarët policorë të Kosovës, të cilët u liruan nga autoritetet e Serbisë, arritën të hënën në Kosovë përmes vendkalimit kufitar në Merdar. Pasi kaluan kontrollin serb, ata hynë në makina të Policisë së Kosovës dhe u

nisën drejt Prishtinës, pa u deklaruar për mediet që ishin të pranishme. Të arrestuar nga forcat serbe qysh më 14 qershor, ata u liruan paraditën e së hënës. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës ka thënë se ky rrëmbim

konsiston me një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe duhet qortuar. "Agresioni serb duhet të mbahet përgjegjës", ka thënë kryeministri Albin Kurti në deklaratën e tij pas lirimit të tre policëve

**KOSOVA
DHE AJOA
NËNSHKRUAJNË
MARRËVESHJE
PËR RRIJJE TË
BASHKËPUNIMIT**

FAQE 3



**NË GJILAN MBAHET
TRYEZË DISKUTIMI
LIDHUR ME
PROBLEMATIKËN E
QYTETARËVE TË
DËBUAR NGA LUGINA
E PRESHEVËS**

FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCËSHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NATO-ja thotë se rebelimi i Wagnerit tregoi gabimin e Moskës për sulm ndaj Kievit

BRUKSEL, 26 QERSHOR - Rebelimi i ndërprerë i grupit mercenar rus Wagner në fundjavë e ka demonstruar shkallën e gabimit strategjik të Kremlinit kur e ka nisur luftën në Ukrainë, ka thënë sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të hënën.

Rusia ka tentuar ta rikthejë qetësinë të hënën, pasi luftëtarët e Wagnerit e kanë ndërprerë avancimin drejt Moskës, janë larguar prej qytetit të kapur rus Rostov-on-Don dhe janë nisur drejt bazave të tyre në orët e vona të së shtunës, pas arritjes së një marrëveshjeje që u garanton siguri.

Sipas marrëveshjes - të ndërmjetësuar nga lideri bjellorus Alexander Lukashenka - komandanti i tyre, Yevgeny Prigozhin, duhet të shkojë në Bjellorusi.

"Ngjarjet e fundjavës janë një

çështje e brendshme dhe një tjetër demonstrim i një gabimi të madh strategjik që presidenti [Vladimir] Putin e ka bërë kur e ka nisur aneksimin e Krimesë dhe luftën në Ukrainë", ka thënë Stoltenbergu nga Vilnisi, kryeqyteti i Lituaniës.

Konfuzioni për ngjarjet e jashtëzakonshme të fundjavës i ka lënë qeveritë e Perëndimit në kërkim të përgjigjeve se çfarë mund të ndodhë në këtë shtet me arsenal të fuqishëm bërthamor - dhe me luftën që vazhdon të zhvillohet në Ukrainë.

Stoltebergu ka thënë se NATO-ja është duke e monitoruar situatën në Bjellorusi dhe e ka dënuar vendimin e Moskës për të dërguar armë bërthamore atje. "Ne nuk kemi parë shenja që Rusia është duke u përgatitur për t'i përdorur armët bërthamore, mirëpo NATO-ja



mbetet vigjilente", ka thënë Stoltenbergu, duke shtuar se mbrojtja e NATO-s është mjaftueshëm e fuqishme për t'i mbajtur njerëzit të sigurt "në një

botë të rrezikshme". Në të njëjtën kohë, Stoltebergu e ka ritheksuar mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s për Kievin. "Nëse Rusia mendon se

mund të na frikësojë nga ofrimi i ndihmës në Ukrainë, do të dështojë", ka thënë ai.

"Ne do të jemi afër Ukrainës sa të ketë nevojë".

Stoltenbergu ka qenë në Lituani për t'i parë nga afërt stërvitjet e NATO-s.

Ai ka thënë se stërvitjet dërgojnë mesazh të qartë se NATO-ja është e gatshme të mbrojë çdo inç të aleancës.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Gjermania do t'i stacionojë 4 000 trupa ushtarake në Lituani



Berlin, 26 qershor - Gjermania planifikon t'i dërgojë 4 000 trupa shtesë të NATO-s në Lituani për të ndihmuar në sigurimin e krahut lindor të aleancës, ka thënë ministri gjerman i Mbrojtjes, Boris Pistorius.

"Gjermania është e gatshme ta stacionojë me afat të përhershëm një brigadë të madhe në Lituani", ka thënë Pistorius gjatë një vizite në kryeqytetin lituanëz Vilnius.

Sipas ministrit gjerman, do të duhet të ndërtohen objekte për t'i akomoduar trupat.

Lituania i ka kërkuar vazhdimisht Gjermanisë që t'i dërgojë trupa

ushtarake në territorin e saj. Lituania është në kufi me enklavën ruse Kaliningrad.

Gjermania është zotuar në qershor të vitit 2022 se do ta ketë një brigadë të gatshme për ta mbrojtur Lituani në rast sulmi.

Megjithatë, deri më tani Berlini i ka rezistuar idesë së krijimit të një baze të përhershme në Lituani, duke insistuar se trupat mund të angazhohen shpejt prej bazave të tyre në Gjermani.

Aktualisht qindra ushtarë gjermanë janë në Lituani në kuadër të NATO-s.

Në rast të rritjes së tensioneve,

qeveria gjermane ka thënë se një brigadë e madhe mund të transferohet në Lituani brenda 10-ditësh.

Deklarata e Pistoriusit në Lituani - ku është duke realizuar vizitë për t'i vëzhguar stërvitjet e NATO-s dhe për t'u takuar me zyrtarë të aleancës - është deklarata e parë e qartë gjermane për këtë çështje.

Gjermania i ka dërguar në Lituani rreth 300 tanke dhe pajisje të tjera, bashkë me 1 000 ushtarë për të marrë pjesë në stërvitjet e NATO-s, të cilat janë duke u mbajtur për herë të tretë.

Kievi thotë se ka çliruar 130 kilometra katrorë që prej nisjes së kundëroffensivës

KIEV, 26 QERSHOR - Forcat ukrainase e kanë rikthyer kontrollin e 130 kilometrave katrorë në jug që prej nisjes së kundëroffensivës, ka thënë zëvendësministri ukrainase e Mbrojtjes, Hanna Malayar, më 26 qershor.

Ajo ka thënë në Telegram se ushtria ukrainase vazhdon të avancojë në Melitopol dhe Berdjansk, që gjenden në rajonin Zaporizhja, pavarësisht prej rezistencës së ashpër ruse dhe humbjeve "të konsiderueshme" në njerëz dhe pajisje. Sipas saj, përgjatë fundjavës, zona e territoreve të çliruara është rritur për 17 kilometra katrorë. "Në total, që prej nisjes së kundëroffensivës, zona e çliruar në jug shkon në 130 kilometra katrorë",

ka thënë ajo.

Ndaras Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë ukrainase ka thënë në raportin ditor më 26 qershor se forcat ukrainase kanë zbrapsur me sukses sulmet ruse në rajonet e Donjeckut, dhe i kanë zbrapsur 36 sulme në Liman, Bahmut, Avdivka, Marinaka dhe zona të tjera përreth.

Më 25 qershor presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka diskutuar për kundëroffensivën me presidentin amerikan Joe Biden, duke thënë se palët i kanë koordinuar "pozicionet e tyre" para samitit të NATO-s që mbahet më 11-12 korrik në Lituani.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan



luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Kosova dhe Ajoa nënshkruajnë marrëveshje për rritje të bashkëpunimit

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani dhe guvernatorja e shtetit të Ajoas, Kim Reynolds, kanë nënshkruar të hënën në Prishtinë marrëveshjen e marrëdhënies së shteteve simotra dhe bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Reynolds ka bërë me dije se shteti që drejton ajo është i hapur për ta zgjeruar bashkëpunimin me Kosovën në fushën e sigurisë, edukimit dhe atë komerciale

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Guvernatorja e shtetit të Ajoas, Kim Reynolds, ka thënë të hënën se shteti që drejton ajo është i hapur për ta zgjeruar bashkëpunimin me Kosovën në fushën e sigurisë, edukimit dhe atë komerciale. Guvernatorja amerikane i ka bërë këto deklarata në një konferencë për medie në Prishtinë, bashkë me presidenten e Kosovës, Vjosa

Osmani, pas nënshkrimit të marrëveshjes për vazhdim të bashkëpunimit mes vendeve simotra.

Dy vendet kanë nënshkruar marrëveshje binjakëzimi më 2013.

Presidentja Osmani ka thënë se marrëveshja e re dëshmon përkushtimin për të hapur kapituj të rinj në raportet dypalëshe në "fusha të ndryshme të interesit të ndërsjellë, përfshirë arsimin, kulturën, turizmin, bujqësinë, tregtinë dhe fushën e



energjisë". "Sot me guvernatoren Kim Reynolds, hapëm kapituj të ri në partneritetin tonë me Iowan, duke dëshmuar edhe një herë përkushtimin tonë të çdoditshëm për forcim të aleancës dhe miqësisë me Shtetet e Bashkuara. Marrëveshja do të ofrojë instrumente për koordinim të shtuar në mes të dy vendeve tona edhe në fushën e mbrojtjes, një bashkëpunim esencial në mes të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Gardës së Ajoas", ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se qytetarët e Kosovës do të kenë përfitime të drejtpërdrejta nga marrëveshja. Osmani ka folur edhe për situatën aktuale në Kosovë dhe ka thënë se autoritetet janë të përkushtuara t'i tejkalojnë të gjitha sfidat në fushën e sigurisë.

"Kosova, si gjithnjë, është plotësisht e përkushtuar për paqe dhe stabilitet afatgjatë në vend dhe rajon, në koordinim të plotë me aleatët tanë", është shprehur Osmani.

Në maj të vitit 2021 trupat e FSK-së, së bashku me anëtarët e Gardës Kombëtare të Ajoas, e kanë nisur një mision të përbashkët në Kuvajt.

Ky ka qenë misioni i parë i FSK-së jashtë vendit.

Dy vendet kanë bashkëpunuar në të kaluarën edhe në fushën e biznesit dhe shkëmbimeve në fushën e arsimit. Ato e kanë aktiv edhe programin "Gratë në Energji". Më 2021, 26 persona nga Kosova i kanë përfunduar studimet dyvjeçare në fushat e lidhura me energjinë në Des Moines Area Community College.

Në Gjilan mbahet tryezë diskutimi lidhur me problematikën e qytetarëve të dëbuar nga Lugina e Preshevës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

GJILAN, 26 QERSHOR - Nën organizimin e zyrës së kryetarit të Gjilanit, përkatësisht Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, është mbajtur tryezë diskutimi lidhur me krerët institucionale lidhur me problematikën e qytetarëve të dëbuar nga Lugina e Preshevës të cilët jetojnë në Republikën e Kosovës.

Në këtë tryezë, pos kryetarit të komunës, Alban Hyseni, ka marrë

edhe këshilltarja e kryeministrit të Kosovës, Ardita Sinani, kryetarit i Bujanocit, Nagip Arifi, nënkryetari i Preshevës, Almin Shaqiri, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Arianit Sadiku, përfaqësues të Këshillit Nacional Kombëtar, edhe deputetët e Kuvendit të Republikës, Luan Aliu dhe Arjeta Rexhepi.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, pasi konstatoi problematikën e madhe që përballen qytetarët e Luginës lidhur me mungesën e pajisjes me dokumentacion të Republikës së

Kosovës dhe pasivizimin e adresave në komunat përkatëse, theksoi se bashkërisht do të punojmë për gjetjen e mundësive që këta qytetarë sa më parë të pajisen me dokumentacionin e nevojshëm.

Në këtë takim, po ashtu, është paraqitur edhe një raport nga Zyra për Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, mbi gjendjen reale dhe problemet që ballafaqohen çdo ditë qytetarët e Luginës së Preshevës të cilët jetojnë në komunën e Gjilanit.

Të enjten Kuvendi mblidhet në seancë plenare

Prishtinë, 26 qershor - Mbledhja e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, e paraparë për të hënën në orën

12:00, nuk u mbajt në mungesë të kuorumit. Megjithatë, konform kompetencave të tij dhe në

konsultim me përfaqësues të grupeve parlamentare, kryetari Glauk Konjufca vendosi që Kuvendi të mblidhet në seancë

plenare të enjten, më 29 qershor 2023, në orën 12:00, për t'i shqyrtuar pikat e mbetura nga seancat e kaluara.





Lirohen tre policët e Kosovës që mbaheshin në Serbi

Tre zyrtarët policorë të Kosovës, të cilët u liruan nga autoritetet e Serbisë, arritën të hënën në Kosovë përmes vendkalimit kufitar në Merdar. Pasi kaluan kontrollin serb, ata hynë në makina të Policisë së Kosovës dhe u nisën drejt Prishtinës, pa u deklaruar për mediet që ishin të pranishme. Të arrestuar nga forcat serbe qysh më 14 qershor, ata u liruan paraditen e së hënës. Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës ka thënë se ky rrëmbim konsiston me një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe duhet qortuar. “Agresioni serb duhet të mbahet përgjegjës”, ka thënë kryeministri Albin Kurti në deklaratën e tij pas lirimit të tre policëve

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Gjykata në Krlevë të Serbisë urdhëroi të hënën lirim nga paraburgimi të tre policëve të Kosovës që po mbaheshin në paraburgim që nga 14 qershori. Në një deklaratë të gjykatës “konfirmohet aktakuza kundër të pandehurve dhe mori vendimin me të cilin të pandehurve u ndërpritet paraburgimi”. Tre policët e Kosovës akuzohen për “prodhim, posedim, mbajtje dhe trafik të paautorizuar të armëve dhe lëndëve shpërthyes”. Arrestimi i policëve më 14 qershor shtoi tensionet midis dy vendeve. Autoritetet në Prishtinë thanë se policët janë rrëmbyer brenda

territorit të Kosovës duke e akuzuar Serbinë për “cenim të sovranitetit dhe tërësisë tokësore” të Kosovës. Beogradi thotë se policët janë kapur brenda territorit të Serbisë. Shtetet e Bashkuara dhe një pjesë e vendeve europereëndimore kërkuan lirim e pakusht të policëve dhe hedhjen e hapave për shtensionimin e situatës në veri të Kosovës. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se ky rrëmbim konsiston me një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe duhet qortuar. “Agresioni serb duhet të mbahet përgjegjës”, ka thënë ai, duke u shprehur i gëzuar për kthimin e policëve të familjet e tyre. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se lirimi i

policëve “nuk e liron Serbinë nga përgjegjësia për këtë akt flagrant të agresionit kundër Kosovës”. Osmani falënderoi Shtetet e Bashkuara “për gjithë punën që kanë bërë për lirim e tre policëve të Republikës së Kosovës që po mbaheshin të kidnapuar pas aktit të agresionit që Serbia kishte kryer ndaj Republikës së Kosovës”. Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, ka thënë se përndjekja e policëve nga Serbia do të vazhdojë në liri, “ndonëse lirimi i tyre sot është lajm i mirë”. “Konfirmimi i aktakuzës dhe lirimi në procedurë të rregullt është vazhdim i orvatjeve të Serbisë për ta mbuluar agresionin policoro-ushtarak brenda territorit të Republikës së Kosovës”, ka deklaruar Sveçla, duke përsëritur se policët “kanë

qenë në detyrë zyrtare brenda territorit të Republikës” kur janë arrestuar. “Ata duhet të lirohen pa kushte dhe Serbia duhet të mbahet përgjegjëse për cenimin e integritetit territorial të Republikës së Kosovës”, ka thënë Sveçla. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka theksuar se “kthimi i policëve të Kosovës në shtëpi është një lajm i vonuar, por gjithsesi shumë i mirë”. “... sepse, e para, i jep fund heqjes arbitrarë të lirisë së tre njerëzve që s’kanë kryer asnjë krim dhe, e dyta, rihap rrugën e deeskalimit e të dialogut”, ka shkruar Rama në “Twitter”. Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka theksuar se lirimi i tre policëve nga mbajtja arbitrarë në Serbi - Rifat Zekës, Beqir Sefës e Shemsi Mustafës, megjithëse mjaft i vonuar, është lajm i mirë për familjet e tyre dhe për qytetarët e shtetit tonë. “Falënderoj të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë, të cilët u angazhuan dhe luajtën rol vendimtar në këtë proces. Tani radha është për shtensionimin e situatës në pjesën veriore të vendit dhe për rikthimin e normalitetit atje përmes veprimeve të matura dhe të

përgjegjshme politike”, ka shkruar Krasniqi në “Facebook”. Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas lirimit të tre policëve. “Lidhja Demokratike e Kosovës ka mirëpritur lajmin për lirim e tre policëve tanë, Rifat Zeka, Beqir Sefa e Shemsi Mustafa, të cilët 12 ditë më parë u kidnapuan nga forcat serbe brenda territorit të Kosovës, në një akt të agresionit luftënxitës. Sot i falënderojmë të gjithë miqtë tanë ndërkombëtarë, që në vazhdimësi kanë dënuar aktin e Serbisë, sikurse dhe kanë shtuar presionin për lirim e menjëhershëm të tyre. Në veçanti, falënderojmë Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për angazhimin. Lidhja Demokratike e Kosovës vlerëson se sjelljet agresive e luftënxitëse të Serbisë duhet të dënohen nga komuniteti ndërkombëtar, prandaj koordinimi i veprimeve të institucioneve të Kosovës me aleatët tanë është domosdoshmëri”, është theksuar në reagimin e Abdixhikut. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka theksuar se lirimi i tre policëve të Kosovës është

IKD-ja: Ndryshimi i rregullores për emërimin e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të Prokurorive të kalojë përmes procesit të konsultimit publik

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka reaguar ndaj Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i cili ka vendosur që në takimin e radhës ta miratojë ndryshim/plotësimin e rregullores për emërimin e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës pa e vënë këtë të fundit në dëgjim publik.

Rregullorja nr. 06/2019 për emërimin e kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës është miratuar nga KPK në vitin 2019.

KPK-ja më 31 maj 2023 ka marrë vendim ta bëjë ndryshim/plotësimin e kësaj rregullore për shkak se më 1 qershor 2023 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit i cili ligj ka paraparë kritere të tjera për përzgjedhjen e kryeprokurorëve të prokurorive.

Deri te ndryshim/plotësimi i ngutshëm i kësaj rregullore ka ardhur edhe për shkak se KPK më 23 maj 2023 kishte shpallur konkursin për kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, konkurs ky që ishte shtyrë pastaj deri në ndryshim/plotësimin e rregullores së lartcekur.

KPK ka ndërtuar një standard të konsultimit publik me rastin e miratimit të legjislacionit sekondar nga ana e Këshillit Prokurorial. "Me keqardhje kemi kuptuar se i njëjti Këshill ka devijuar nga një praktikë dhe standard i tillë edhe lidhur me rregulloren e lartcekur. Duke pasur parasysh që një rregullore e tillë është e rëndësishme së madhe për shkak se me të njëjtën përcaktohen kriteret dhe procedurat e zgjedhjes së krerëve të prokurorive, tejkalimi i konsultimit publik dhe mohimi i aktorëve të shoqërisë civile dhe palëve të interesit për të qenë pjesë e këtij procesi, ngrit dyshime të arsyeshme lidhur me transparencën, llogaridhënien dhe integritetin e Këshillit Prokurorial të Kosovës për ta përmirësuar procesin e



emërimit të kryeprokurorëve në mënyrë të drejtë, të pavarur, të paanshme dhe të bazuar në meritokraci", thuhet në reagimin e IKD-së.

IKD-ja thekson faktin se shqetësimet dhe kritikrat e ngritura për këtë rregullore janë të mëhershme, pra qysh në reagimet e koalicionit të OJQ-ve lidhur me integritetin e kontestuar të procesit të përzgjedhjes së kryeprokurorit të Shtetit.

Organizatat joqeveritare Instituti i Kosovës për Drejtësi, Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Lëvizja FOL (tutje: Koalicioni), së bashku kishin bërë monitorimin dhe vlerësimin e procesit të përzgjedhjes dhe emërimit të kryeprokurorit të Shtetit, nga edhe ishte kërkuar që ky proces të anulohet në tërësi për shkak të shkeljeve procedurale dhe

defekteve të evidentuara nga koalicioni në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të këtij procesi.

Sipas gjetjeve të koalicionit, përkundër se Kushtetuta dhe ligjet bazike promovojnë një proces të pavarur, të drejtë dhe të paanshëm që garanton meritokracinë, këtë frymë e pengon si udhëzuesi ashtu edhe formulari i koncept -okumentit për kandidatët për kryeprokuror të Shtetit.

Sa i përket udhëzuesit, i njëjti është i orientuar më shumë drejt vlerësimit të njohurive teorike sesa i bazuar në shkathtësi dhe aftësi të cilat ndërliken me pozitën e kryeprokurorit.

Shumica e pyetjeve në formularin e koncept-dokumentit për kryeprokuror të shtetit janë të bazuara në ligjet e shfuqizuara dhe kohën kur kryeprokurori i Shtetit

njëkohësisht ishte edhe kryesues i KPK-së.

Shumë pyetje në këtë formular ndërliken me proceset që janë kompetencë e KPK-së dhe jo kryeprokurorit të Shtetit.

Për arsyet e lartcekura, një nga rekomandimet kryesore të koalicionit të OJQ-ve kishte qenë rekomandimi që KPK-ja ta plotësojë dhe ndryshojë rregulloren për procesin e përzgjedhjes dhe emërimit të kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve, me theks të veçantë formularin e koncept-dokumentit. "Tejkalimi i fazës së dëgjimit publik për një rregullore me rëndësi të veçantë për sistemin prokurorial e kthen mbrapa Këshillin sa i përket transparencës dhe llogaridhënies në raport me qytetarët, shoqërinë civile dhe mediet në Republikën e Kosovës. Po ashtu, mosinkorporimi i

publikut në fazën e draftimit të këtyre ateve iu pamundëson këtyre të fundit ta shprehin interesimin për pjesëmarrje në procesin e konsultimit publik për të dhënë propozime dhe komente në çështje të ndryshme", është thënë në reagimin e IKD-së.

Andaj, IKD-ja kërkon nga KPK-ja t'i respektojë standardet minimale sa i përket konsultimit publik për hartimin e akteve të Këshillit dhe, në rastin konkret, të mos e miratojë ndryshim/plotësimin e rregullores së lartcekur, por të njëjtën ta tërheqë nga rendi i ditës së takimit të 23-të dhe ta obligojë Komisionin për Çështje Normative që aktin e tillë ta vë në dëgjim publik sipas afateve të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2023 për Hartimin e Akteve Normative të KPK-së.

lajm i mirë, para së gjithash për familjet e tyre dhe për Kosovën, por kjo nuk nënkupton që kjo ngjarje mund të konsiderohet e mbyllur vetëm me lirimin e tyre. "As presidenti i Serbisë e as kryeministri i Kosovës nuk mund t'i ikin përgjegjësisë së tyre, e cila çoi në rrëmbimin e policëve dhe mbajtjen e tyre në paraburgim e pa asnjë faj për mirëmbajtjen e tyre në shumë se dhjetë ditë", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se Policia e Kosovës nuk duhet të paguajë çmim për veprimet e papërgjegjshme e kalkuluese politike të regjimit në Serbi, apo

të veprimeve të papërgjegjshme të qeverisë në Prishtinë, e cila çoi në rrëmbimin e policëve të Kosovës dhe mbajtjen e tyre në paraburgim e pa asnjë faj, për më shumë se dhjetë ditë. "Lirimi i tyre është bërë i mundur vetëm falë ndërhyrjes së diplomacisë amerikane, prandaj gjithë falënderimi dhe mirënjohja jonë shkon për ta", ka shkruar Haradinaj.

Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, ka shkruar në rrjetet sociale se presidenti serb, Aleksandër Vuçiq, e ka njoftuar "se në përputhje me kërkesën e bërë në takimin tonë javën e kaluar, autoritetet serbe së

shpejti do t'i lirojnë nga paraburgimi tre policët e Kosovës të arrestuar më parë".

Ai tha se e vlerëson shumë hapin e presidentit Vuçiq, "të cilën ai e mori në një periudhë sfidash serioze dhe vendim i cili është një dëshmi e qartë e bashkëpunimit strategjik mes vendeve tona dhe e përkushtimit tonë të ndërsjellë për paqen dhe qëndrueshmërinë e Ballkanit". Tensionet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë u rritën në fund të muajit të kaluar kur autoritetet nisën ta zbatojnë rezultatin e zgjedhjeve të 23 prillit, të bojkotuar nga partitë politike serbe. Në

komunat veriore grupe qytetarësh serbë po vazhdojnë ta kundërshtojnë vendosjen nëpër zyra komunale të kryetarëve shqiptarë.

Arrestimi i tre pjesëtarëve të policisë shtoi edhe më shumë tensionet ndërmjet palëve.

Shefi i diplomacisë evropiane, Josep Borrell, takoi ndarazi në Bruksel të enjten më 22 qershor kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe presidentin serb, Aleksandër Vuçiq, në përpjekje për të gjetur rrugëdalje nga kriza. Borrelli tha pas takimeve se është arritur pajtimi për nevojën e mbajtjes së zgjedhjeve të reja veri të Kosovës, ndërsa ua

paraqiti palëve pritjet e Bashkimit Evropian për shtensionimin e situatës. "Për Kosovën që menjëherë t'i pezullojë operacionet policore në ndërtesat e komunave në veri dhe që katër kryetarët e komunave përkohësisht t'i kryejnë detyrat jashtë zyrave komunale. Serbia të sigurojë që protestuesit të largohen nga ndërtesat e komunave njëkohësisht me largimin e Policisë së Kosovës", ka theksuar Borrelli.

Të dyja palët, tha ai, duhet t'i shpallin zgjedhjet e reja në të katër komunat, me pjesëmarrje të pakusht të serbëve në to.

Namazi i Kurban Bajramit falet të mërkurën në orën 05:38

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) ka bërë me dije se namazi i Kurban Bajramit do të falet të mërkurën më 28 qershor 2023 në orën 05:38. Në njoftimit e BIK-ut është thënë se manifestimi qendror për territorin e Kosovës do të mbahet në "Xhaminë e Madhe" në Prishtinë. "Kurban Bajrami të mërkurën, më 28 qershor 2023 (namazi i Kurban-Bajramit falet në orën 5.38 min.) Kryesia e Bashkësisë

Islame të Kosovës njofton besimtarët dhe opinion e gjerë se dita e parë e festës së Kurban Bajramit është ditën e mërkurë, më 28 qershor 2023. Manifestimi qendror për territorin e Kosovës, kushtuar festës së Kurban - Bajramit, mbahet në 'Xhaminë e Madhe' në Prishtinë. Namazi i sabahut falet në orën 4.23 min. Ligjëratën tematike kushtuar festës së Kurban Bajramit do ta mbajë dr. Selatin Mehani, pedagog në Medresenë

'Alaudin' në Prishtinë. Namazi i Kurban Bajramit falet në orën 5.38 min, të cilit do t'i prijë Burhanudin ef. Hashani, kryeimam i Prishtinës, ndërsa hytben - mesazhin e Kurban Bajramit do ta mbajë myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë. Me rastin e festës së Kurban Bajramit, ditën e parë, më 28 qershor 2023, Kryesia e BIK-ut, si tradicionalisht, organizon pritje përurimi në selinë e Kryesisë nga ora 9:00-12:00", ka njoftuar BIK-u.



Kryeqyteti shpalosi planin e sigurisë për shkolla

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryeqyteti do të vendosë kamera të sigurisë në secilin institucion edukativ arsimor në Prishtinë, po ashtu aty ku nuk ka, do të vendosen sistemet e sigurimit dhe shkollat do të pajisen me pako të ndihmës së parë.

Të gjithë nxënësit do të pajisen me uniforma, do të krijohet një kod etik për çdo IEAA dhe do të krijohet një rregullore për përdorim të telefonave nga nxënësit e mësimdhënësit.

Në institucionet edukative arsimore nuk do të mungojë prania e policisë. Këto janë disa nga veprimet të cilat do t'i ndërmarë Drejtoria e Arsimit për të ofruar siguri në shkolla. Këto masa e të tjera u prezantuan të hënën nga drejtoresha e arsimit në kryeqytet, Besianë Musmurati. "Objektivat janë infrastruktura shkollore që garanton siguri, përmirësimi i klimës së shkollës, rritja e sigurisë

nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas", ka deklaruar Musmurati.

Ndërsa kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, vlerësoi punën e Drejtorisë së Arsimit për hartimin e këtij plani ku janë përfshirë edhe shumë institucione e organizata të tjera. "Aktivitetet konkrete që ky plan paraqet për t'u zhvilluar brenda në klasë, punëtoritë e drejtuara nga psikologët dhe mësimdhënësit do t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësi për identifikimin e dhunës, parandalimin e sjelljes delikvente, raportimin e dhunës, të menduarit kritik dhe reflektimin mbi dhunën ose ngacmimin e paqëllimshëm", ka thënë Rama.

Në këtë plan janë të përfshirë edhe vetë nxënësit, të cilët, po ashtu, kanë mbajtur fushatë vetëdijesuese "Çohu kundër dhunës".



Peja të hënën kishte ditë zie



Pejë, 26 qershor - Të hënën është mbajtur ditë zie në Pejë në nderim të dy viktimave që kanë humbur jetën të shtunën në Pejë si pasojë e vërshimeve, një nënë me të birin e saj pesëvjeçar. Ky vendim është marrë nga kryetari i kësaj komune, Gazmend Muhaxheri.

Pas vendimit të gjitha angazhimet institucionale janë pezulluar, ndërsa flamujt janë vendosur në gjysmështizë. Komuna e Pejës është përballur me vërshime të mëdha në disa zona të rëndësishme të qytetit.

Dëmet materiale në shtëpi, dyqane, objekte publike dhe në infrastrukturë rrugore janë të mëdha. Komuna e Pejës ka mobilizuar Shtabin Emergjent për t'i adresuar nevojat dhe sfidat që dalin nga ky fenomen natyror. Njësitet e FSK-së të kërkimshpëtimit kanë dalë në terren për të ndihmuar për përballimin e situatës. Familjes Ademaj, e cila humbi dy anëtarë të saj si pasojë e vërshimeve, i kanë shprehur ngushëllime përfaqësuesit e institucioneve dhe liderët e partive opozitare.

Komuna e Mitrovicës përfiton edhe një kamion për mbeturina nga MMPHI-ja

MITROVICË, 26 QERSHOR - Komuna e Mitrovicës ka përfituar edhe një kamion për grumbullimin e mbeturinave me kapacitet 8m3 nga Gara për Mjedis të Pastër.

Në ceremoninë e ndarjes së këtij granti mori pjesë drejtori i Drejtorisë për Mbrojtje të Mjedisit, Egzon

Sadiku, si dhe udhëheqësi i Sektorit të Mbeturinave, Irfan Peci.

Me rastin e pranimit të kamionit, drejtori Sadiku ka thënë se ky kamion i ri ka një rëndësi të jashtëzakonshme sepse do të ndihmojë që të kemi një mjedis sa më të pastër dhe të shëndetshëm

në qytetin e Mitrovicës.

Po ashtu, drejtori Sadiku i ka falënderuar zyrtarët e Drejtorisë së Mjedisit dhe KRM "Uniteti" për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre për përmirësimin e mjedisit, ku pa përkushtimin dhe kontributin e tyre nuk do të ishte realizuar kjo punë e mirë.



Shefi i ri i EULEX-it merr detyrën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Giovanni Pietro Barbano, gjeneralmajor i Karabinierisë së Italisë me më shumë se 40 vjet përvojë në ligj dhe rend, aktivitete të policisë, dhe operacione të paqes, mori të hënën detyrën si shef i Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Ai pason diplomatin suedez, ambasadorin Lars-Gunnar Wigemark, i cili përfundoi detyrën si shef i misionit më 25 qershor. "Ndiej një përgjegjësi të madhe gjersa marr sot detyrën si shef i EULEX-it, një partner strategjik i Kosovës në fushën e sundimit të ligjit dhe sigurisë. Duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për mandatin jetik të Misionit, unë do të punoj me integritet dhe profesionalizëm për ta vazhduar moton e Misionit 'Partneritet për drejtësi', për të ndikuar pozitivisht në terren dhe për t'i avancuar synimet tona të përbashkëta për sundimin e ligjit në Kosovë", ka theksuar Barbano.

Shefi i ri i EULEX-it pranoi se misioni operon në një kontekst ende të vështirë, në mes të tensioneve të ngritura, dhe shtoi: "Misioni është mjet i shkëlqyeshëm për reagimin e gjerë të BE-së ndaj sfidave të sigurisë, duke pasur parasysh që EULEX-i është reaguesi i dytë i Kosovës në fushën e sigurisë. Në kuadër të mandatit që ka, Misioni do të vazhdojë ta mbështesë stabilitetin e Kosovës si dhe sigurinë e të

gjitha komuniteteve të saj", ka deklaruar Barbano.

Duke folur rreth mandatit të EULEX-it për monitorim të thuktë, Barbano tha: "EULEX-i do të vazhdojë t'i monitorojë nga afër rastet e përzgjedhura në nivel policor, prokurorial dhe gjyqësor, dhe në nivel korrektues, për të vlerësuar se si ato raste trajtohen nga autoritetet e Kosovës. Mes të tjerash, monitorimi do të përqendrohet në respektimin e të drejtave të njeriut, garancitë për gjykime të drejta, si dhe trajtimin e barabartë për të gjithë, përfshirë pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në Kosovë. Ndihej i nderuar nga besimi që shtetet anëtare më kanë dhënë, dhe me padurim pres ta vazhdoj trashëgiminë e paraardhësit tim, Lars-Gunnar Wigemark", ka theksuar Barbano.

EULEX-i ka filluar punën në vitin 2008 dhe mandati aktual i tij mbulon periudhën deri më 14 qershor 2025 bazuar në vendimin e këshillit 2023/1095. Misioni i përgjithshëm i EULEX-it është mbështetja e institucioneve të përzgjedhura të sundimit të ligjit në Kosovë. Në veçanti, Misioni është reaguesi i dytë i Kosovës në fushën e sigurisë në kuadër të një mekanizmi treshtresor të reaguesve të sigurisë, ku Policia e Kosovës vepron si reaguesi i parë dhe KFOR-i si reaguesi i dytë; e këshillon Drejtorinë Rajonale Veri të Policisë së Kosovës dhe katër stacionet policore nën komandën e saj mbi një sërë çështjesh që lidhen me ofrimin e



shërbimeve policore; u asiston autoritetet e Kosovës për fuqizimin e institucioneve të sundimit të ligjit përmes monitorimit të thuktë të rasteve në nivel policor, prokurorial dhe gjyqësor; mbështet Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes monitorimit, mentorimit dhe këshillimit;

punon së bashku me homologët vendas në Institutin e Mjekësisë Ligjore për gjetjen e fatit të personave të zhdukur përmes ofrimit të ekspertizës dhe këshillave; u asiston Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës; vazhdon ta menaxhojë

programin e tij për mbrojtjen e dëshmitarëve; dhe mbështet Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar përmes facilitimit të shkëmbimit të informatave në mes të Policisë së Kosovës dhe Interpolit, Europolit apo Ministrisë së Brendshme të Serbisë.

Kurti takon sekretarin për Punë të Jashtme të Britanisë, flasin për thellimin e marrëdhënieve të dy vendeve



LONDËR, 26 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u prit në takim nga sekretari për punë të jashtme i Mbretërisë së Bashkuar, James Cleverly. Falënderues për mikpritjen dhe bashkëpunimin e sekretarit Cleverly, kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen e tij për mbështetjen e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar ndaj Kosovës dhe popullit të saj në të gjitha etapat e shtetformimit, shtetndërtimit dhe zhvillimit.

Në takim u fol për marrëdhëniet e shkëlqyera ndërmjet dy vendeve si dhe për mundësitë dhe fushat në të cilat ato mund të forcohen dhe thellohen.

Zhvillimet e fundit në Republikën e Kosovës dhe situata në katër komunat në veri të vendit ishin temë e këtij

takimi.

Kryeministri Kurti e njoftoi sekretarin Cleverly me propozimin e tij për shtensionimin e situatës, duke theksuar se sundimi i ligjit është parimi bazë për adresimin e sulmeve ndaj Policisë së Kosovës, ushtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve gjatë ditëve të tensionuara në ato komuna dhe që mundëson mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme në po ato komuna e të cilat duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të lira e demokratike dhe me fushatë të hapur dhe fer.

Kryeministri Kurti po zhvillon një vizitë pune dyditore në Britani të Madhe.

Ky ishte takimi i dytë i tij me sekretarin Cleverly.

Takimi i parë ishte mbajtur në tetor të vitit të kaluar, po ashtu në Mbretëri të Bashkuar.

Mbi 21 000 familje përfituan nga skema e ndihmës sociale në muajin maj

EPOKA E RE**Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin maj. Në muajin maj 2023 nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 21 312 familje, me gjithsej 84 249 anëtarë e që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ishte 25 482 familje me gjithsej 100 608 anëtarë. Pra, vërehet një rënie e numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 4 170 apo shprehur në përqindje 16,3 për qind si dhe rënie e numrit të anëtarëve të familjeve përfituese nga kjo skemë për 16 359 apo shprehur në përqindje 16,2 për qind. Numri i përfituesve nga skema e pensioneve bazike të moshës ishte 145 140 e që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 149 794

përfitues, vërehet rënie prej 4 654 apo shprehur në përqindje 3,1 për qind.

Numri i përfituesve nga skema e pensioneve kontributpaguese të moshës ishte 48 549, ku vërehet rënie e numrit të përfituesve nga kjo skemë pensionale për 1 426 apo shprehur në përqindje 2,9 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 49 975 përfitues.

Nga skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara kanë përfituar gjithsej 18 368 persona, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të përfituesve për 287 apo shprehur në përqindje 1,5 për qind.

Nga skema për pensionet e Trepçës janë 1 558 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rënie të numrit të përfituesve për 341

përfitues apo shprehur në përqindje 17,9 për qind.

Nga skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës janë 730 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të përfituesve për 74 apo shprehur në përqindje për 11,2 për qind.

Nga skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) janë 1 298 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të përfituesve për 49 apo shprehur në përqindje për 3,9 për qind.

Nga skema e kompensimeve për personat e verbër janë 1 815 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të përfituesve për 39 apo shprehur në përqindje 2 për qind.

Nga skema për pensionet familjare janë 3 097 përfitues,

ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rënie të numrit të përfituesve për 275 përfitues apo shprehur në përqindje 8,1 për qind.

Nga skema për pensionet invalide janë 52 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rënie të numrit të përfituesve për 12 përfitues apo shprehur në përqindje për 18,8 për qind.

Nga skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik janë 2 647 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të përfituesve për 370 përfitues apo shprehur në përqindje 16 për qind.

Nga skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 kishte 13 124 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të

përfituesve për 650 apo shprehur në përqindje 5,2 për qind.

Nga skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës janë 12 995 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rënie të numrit të përfituesve për 218 apo shprehur në përqindje 1,6 për qind.

Nga skema për veteranët e luftës janë 36 821 përfitues, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 kemi rënie të numrit të përfituesve për 86 apo shprehur në përqindje 0.2 për qind.

Vërehet një rritje më e theksuar te përfituesit nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara ku kanë përfituar 3 034 familje, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022 ka rritje të numrit të familjeve përfituese për 386 ose 14,6 për qind më shumë.



Banka Evropiane për Investime, e gatshme ta mbështesë Fondin Sovran

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka mirëpritur zëvendëspresidenten e Bankës Evropiane për Investime (EIB), Lilyana Pavlova.

Pavarësisht prej bashkëpunimit të deritanishëm dhe projekteve ekzistuese, në takim u diskutua edhe për bashkëpunimin në të ardhmen, sidomos në fushat prioritare të qeverisë, si ajo e energjisë, arsimit dhe shëndetësisë, në të cilat EIB

mund të japë mbështetje përmes financimit.

Kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen e tij për rolin dhe kontributin e Bankës Evropiane për Investime në zhvillimin e vendeve, duke e cilësuar partnere të rëndësishme.

Në dhjetë vitet e fundit ky institucion financiar ka ofruar mbështetje me vlerë 241 milionë euro në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.

Përveç të tjerash, në takim

kryeministri foli edhe për Fondin Sovran, i cili u prezantua gjatë fundjavës që lamë pas. Me këtë rast, zëvendëspresidentja Pavlova shprehu gatishmërinë e EIB për ta mbështetur qeverinë në këtë nismë.

Ajo theksoi faktin dhe rëndësinë për ta, që Kosova ka një qeveri të qëndrueshme, pozitive të mirë makrofinanciare të saj dhe politika të duhura fiskale që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës.



ADEM DEMAÇI THUAJA 30 VITE ISHTE NË LLOGËRE TË JUGOSLLAVISË E JO NË HOTELE , O TË POSHTËR



Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA

Kur burimi i informatës dhe shpërndarësi janë të pamoralshëm: Baca Adem Demaçi, për miqtë dhe ata që e respektuan dhe Adem Demaçi për ata që kishin mungesë të mjaftueshme respekti për të, nga e gjithë bota ishte cilësuar si i burgosuri me më së shumti burg të mbajtur në Evropë për veprimtari politike duke e quajtur, për mendimin tim pa të drejtë Mandela i Evropës në vend se Mandela të quhej Demaçi i Afrikës, nëse e kemi parasysh trajtimin që iu ishte bërë të dyve, Bacës Adem në llogoret e ish-Jugosllavisë dhe Nelson Mandelës në Afrikën e Jugut. Nelson Mandela kishte trajtim pakrahasimisht më të mirë se që e kishte Baca Adem Demaçi. Ata që kanë qenë bashkë me Bacën Adem nëpër llogoret e ish-Jugosllavisë që u ngjanin kampeve të përqendrimit kanë parë me sytë e tyre se në çfarë kushte ka vuajtur dënimin Baca Adem. Edhe unë isha me të një vit në llogoren e Stara Gradishkës në Kroaci. T'i quaja kushte të tmerrshme është pak nëse e keni për qëllim përshkrimin real të kushteve në ato burgje. Baca Adem Demaçi për herë të parë u dënua me 5 vite burgim në vitin 1958 për shkak të shkrimeve dhe bindjeve politike atdhetare. Për herë të dytë u dënua në vitin 1963

me 15 vite burgim shkak të themelimit të organizatës patriotike: "Lëvizja Revolucionare për Bashkim të Shqiptarëve" dhe vetëm disa muaj pas daljes nga burgu në vitin 1975 u dënua me 15 vite burgim për t'u liruar nga burgu, pas më shumë se 28 viteve burgim në mesvitin e vitit 1990. Në vitin 1991 nga Parlamenti Evropian u nderua me çmimin "Saharov" si i burgosur i ndërgjegjes dhe për lirinë e shprehjes. Herën e tretë u dënua me urdhër të udhëheqësve shqiptarë të Kosovës e që më insistuesi për ta dënua ishte Mahmut Bakalli, një projugosllav dhe antishqiptar. Bashkë me Xhevdet Hamzën, Ali Shukrinë, Fadil Hoxhën, Kolë Shirokën dhe disa "intelektualë shqiptarë" në shërbim të oborrit politik të Aleksandër Rankoviqit dhe Josip Broz Titos. Baca Adem Demaçi ishte në listën e Amnesty International, si i burgosuri me dënime më të larta për bindje politike dhe liri të fjalës për thujta 30 vite. Gjatë këtij rrugëtimi të Marathomakut për Liri dhe Bashkim Kombëtar, Baca Adem Demaçi ka qenë abetare dhe Kushtetutë për të gjithë të burgosurit politikë shqiptarë e që numri i tyre ishte i madh – dominonin në mënyrë absolute krahasuar me të burgosurit

politikë joshqiptarë në llogoret e ish – Jugosllavisë për mënyrën se si mbahet burgu, pa u ankuar asnjëherë të vetme për fatin apo kushtet e tmerrshme në këto llogore ndëshkuese. Kurrë dhe asnjëherë nuk ka pasur asnjë beneficion, asnjë përfitim sepse kurrë nuk ka kërkuar dhe nuk ka pranuar këtë. Për shkak të kushteve të rënda ekonomike dhe se nuk kishte vëlla apo fëmijë të rritur, e vetmja motra Ajeshë e ka vizituar rrallë. As edhe një minutë të vetme nuk e ka kaluar jashtë hapësirës së llogores ku ishte në mbajtje. Ishte në vuajtje të dënimit me ish-disidentin e shquar Mihajllo Mihajllon, i dënua politikisht në ish-Jugosllavi, me ish-kryetarin e Kroacisë, Stipe Mesiq, Vladimir Sheks, Dobrosllav Paraga, Ante Paraxhik dhe të tjerë. Të gjithë këta e theksojnë moralin e lartë dhe qëndrueshmërinë e Bacës Adem edhe në situata kur thjeshtë humbej çdo shpresë... jo vetëm për liri por edhe për jetën. Për t'i përballuar të gjitha situatave, të pritura dhe të papritura, Baca Adem Demaçi e kishte mohuar krejtësisht veten qysh gjatë arrestimit të parë në Burgun e Prishtinës kur e kishte shkruar emrin Adem Demaçi në një copë letër dhe pastaj ia kishte vërë flakën duke u shndërruar në hi

për t'u ringritur dhe ringjallur pastaj si feniksi mitologjik, pikërisht nga hiri i emrit të tij. Të burgosurit politikë shqiptarë dhe ata për vepra të tjera, dritë dhe diell në tunelet e llogoreve të ish-Jugosllavisë e kishim Bacën Adem Demaçin. Ishte engjëlli mbrojtës i yni dhe fanar ndriçues drejt caktit të synuar dhe të gjakuar për të cilin kishim investuar një pjesë të jetës sonë, rruga që shpie drejt lirisë, si kusht i domosdoshëm për bashkim kombëtar!

Gjaku nuk bëhet ujë e as hirra nuk bëhet mazë: Pasi përfundoi burgun e tretë, Baca Adem, siç deklaroi në media, një burg të vogël e zëvendësoi me një burg të madh të quajtur Kosovë. Kosova ishte e robëruar hiç këtu politikanët shqiptarë dhe udbashët që luajtën rol të madh në transformimin e Lidhjes Socialiste të Popullit Punonjës të Jugosllavisë në Lidhje Demokratike të Kosovës. Rahman Morina nën rrogos ishte ai që rekomandoi UDB-në që të regjistrojë LDK-në ndryshe: "do të kemi punë me një parti që do të kishte kërkesa shumë më të mëdha se që i kishte LDK: republikë në kuadër të federatës Jugosllave...". Të burgosurit politikë të liruar në vitet '90 kishin ndikim të madh dhe krediti i tyre

kombëtar dhe politik as që krahasohej me LDK-në ku kishte gjithçka; udbashë, kosistë, politikanë me bindje dhe veprim jugosllav dhe serb, "intelektualë" të shitur deri në palcë në Universitetin e Prishtinës që si edukim nuk e kishin historinë kombëtare por vetëqeverisjen jugosllave, që iu shkruanin fjalime të zjarra politikanëve shqiptarë kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar, që shkruanin romane për politikanët shqiptarë, që denonconin dhe diferenconin intelektualë të vërtetë shqiptarë që ligjëronin mbi gjuhën, të drejtat dhe historinë shqiptare jashtë udhëzimeve jugosllave dhe serbe, që e fshihnin masakrën e Drenicës, masakrën e Tivarit, aksionin e mbledhjeve të armëve, shpërnguljen e dhunshme për Turqi dhe të tjera. Në këto rrethana nuk mund të ndodhte ndryshe përveçse të sulmoheshin të burgosurit politikë shqiptarë të sapokthyer nga llogoret jugosllave. Në veçanti sulmohej Baca Adem Demaçi për shkak të ndikimit të fuqishëm në popull dhe reputacionit që e kishte në skenën ndërkombëtare si mbrojtës i të drejtave të njeriut të të gjithë popujve të robëruar. Thjeshtë, kishin frikë që Baca Adem do të vendosej në anën



tjetër duke kundërshtuar LDK-në përmes mobilizimit të burgosurve politik në një parti e që, as nuk ishte qëllim i Bacës Adem e as i pjesës dërrmuese të të burgosurve politikë. Përkundrazi, Baca Adem fuqishëm ishte kundër përfshirjes së ish të burgosurve politikë në radhët e LDK-së, siç thoshte ai, të mos i dëmtojmë shkakun se ne ishim identifikuar dhe dënuar si kundërshtarë të regjimit jugosllav dhe serb. Madje, na bëri presion që të dalim në zgjedhjet e para dhe ta votojmë Ibrahim Rugovën për president. Mirëpo komunistët dhe udbashët e LDK-së, në frikë se mund ta humbin pushtetin të cilin edhe ashtu nuk e kishin (e kishte Serbia) filluan një fushatë kundër ish të burgosurve politikë duke i akuzuar se janë marksist-leninist në kohën kur vet ishin ngjizur nga komunistët jugosllavë dhe serbë! Jetoja në Podujevë ku në shtator të vitit 1990 së bashku me një grup bashkëmoshatarësh themeluan Nënkëshillin për Mbrotjtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, sipas porosisë së Bacës për të siguruar shtrirje në gjithë territorin e Kosovës si parakusht për ndërtimin e një infrastrukture, sepse e kishim të qartë se lufta është e pashmangshme. Se çfarë sulmesh ka bërë një segment i LDK-së kundër Bacës Adem Demaçi dhe të burgosurve politikë shqiptarë, nuk do të gjeni as në udhëzimet e Gebelsit. Pikërisht, në mesin e këtyre sulmeve doli një “e vërtetë” se Baca Adem nuk paska qenë asnjë ditë në burgjet e Jugosllavisë apo të Serbisë por se paska qëndruar në hotel “Moska” në Beograd për të bërë jetë përrallore duke i shërbyer UDB-së dhe kundër

shqiptarëve! Kësaj valleje i kanë prirë një “shkencëtar” dhe një “shkrimtar” të dy gjallë edhe sot, të pafytyrë atëherë, më shumë fytyra sot. Baca Adem Demaçi u pushkatua atëherë publikisht për shkak të Rambujesë nga një publicist me trashëgimi politike dhe kombëtare jugosllave dhe serbe, nga një kryetar partie për shkak të Ballkanisë dhe nga po këto zorrë të trasha të UDB-së për shkak të Zyrës së Përfaqësuesit Politikë të UÇK-së.

Po me këto gatime nga mielli i UDB-së në një emision të quajtur “Komplot” një pinjoll i UDB-së me mbiemrin Sllamniku u përpoq ta noterizoi të kaluarën politike dhe kombëtare të Bacës Adem Demaçi duke u kapur për dy shtylla; e para se Baca Adem Demaçi nuk paska qenë asnjë ditë në burg dhe e dyta se pa qenë i besuar i UDB-së nuk ka pasur mundësi ta hapë Zyrën e UÇK-së në Prishtinë. Këto “argumente” i ka përdorur LDK-ja për ta diskredituar Bacën si dhe mbetjet jugosllave dhe serbe të shndërruar në manjat të mediave, latifundistë dhe milionerë. Për ta bërë më bindës këtë përrallë të UDB-së dhe mëkëmbësve të saj në Kosovë, pinjollit i brezit udbash Sllamniku (Asllan Sllamniku me të birin Fahrudin dhe kushëririn Imerin - për të cilët dihet me letra se kanë qenë udbashë), ky Arianit Sllamniku (nuk e di se a është degë me rëndësi e trungut udbash të prirë nga Asllan Sllamniku) tregon se kush ka marrë rrogë nga UDB-ja dhe kush ka punuar nga hija (këta qenkan edhe më të rrezikshëm dhe se këtu, me gjasë e sistemon edhe Bacën Adem Demaçin) dhe si pretext e merr familjen Kryeziu duke deklaruar se Hasan Kryeziu, babai i Ekrem Kryeziut e paska

vrarë Bajram Currin prandaj edhe Ekremi, si vazhdimësi e OZNA-s - UDB-së qenka promovuar në regjisor të suksesshëm ndonëse nuk ishte më i mirë në ndërkohë që harron faktin se pikërisht Ekrem Kryeziu me vëllanë Aliun dhe Hasan Alidemajn ka kaluar hetime të tmerrshme si dhe janë dënuar me burg të rëndë. Ndoshta edhe këta sikur edhe Baca Adem Demaçi nuk e kanë kaluar asnjë ditë në burg! Duhet të jesh, jo i painformuar, por shumë i poshtër ta thuash këtë apo duhet të jesh vazhdues i aktiviteteve të hipotekuara antikombëtare të trashëguara nga Asllan Sllamniku, me familjarë e të bësh këtë deklaratë publike! Përmendja e Mehmet Maliqit dhe Shkëlzen Maliqit (nuk e ka përmendur kriminelin Gazmend Maliqin), Selim Broshës dhe Jusuf Karakushit nuk ka të bëjë asgjë me Bacën Adem Demaçi dhe të burgosurit politikë shqiptarë, por ky është një mozaik i vogël i atyre që kanë punuar për UDB-në e kundër shqiptarëve ku Sllamniket ishin dëshmuar si kubëz e besuar e kësaj kotille antikombëtare. Të thirrsh në pohimet e një antishqiptari dhe projugosllavi siç ishte Mahmut Bakalli që paska pohuar se në pyetjen e Bacës drejtuar Bakallit se: “pse nuk e paska vizituar sa paska qenë në burg?”, Bakalli paska thënë se ka qenë por ai (Baca) nuk ishte aty! Çfarë poshtërsie! Shndërroni 28 vite në ditë dhe del se prej 10.220 ditëve, Mahmut Bakalli e paska gjetur një ditë kur Baca nuk ishte në burg! Çfarë poshtërsie! Mahmut Bakalli ka bërë çmos ta dënojë Bacën në vitin 1975 dhe ka bërë çmos që të mbahet sa më gjatë në burg!

Ndërkaq pse e paska rrahur UDB-ja Metush Krasniqin pas takimit

mospajtues me Bacën Adem Demaçi për anëtarësim në organizatën e themeluar nga Baca, pinjollit udbash e qet si denoncim të Bacës Adem Demaçi! Çfarë poshtërsie! Ku ndodhë që një denoncues, pas një denoncimi të tillë të mbahet edhe 25 vite në burg përveç në projeksionet e një të keqi, i ngarkuar me të kaluarën fisnore udbashe. Baca Adem Demaçi dhe Metush Krasniqi kanë qenë patriotë shembullorë, por që kanë pasur mospajtime rreth programit dhe mënyrës së veprimit!

Ndërkaq sa i përket Zyrës së Përfaqësuesit Politikë të UÇK-së në Prishtinë të gjithë e kanë të qartë se vetëm Baca Adem Demaçi ka pasur guxim ta bëjë atë punë sepse, që në Burgun e Parë e mohoi veten duke e shndërruar emrin e tij në hi, duke e vetëmohuar deri në mosekzistencë veten e tij për shkak të interesit të përgjithshëm dhe çështjes kombëtare. Të kastruarit nga këto ndjenja nuk e kuptojnë këtë, për shërimin e komplekseve personale, familjare dhe fisnore, hyjnë në konspiracione, siç po e bënë pinjollit i udbashëve të Asllan, Fahrudin dhe Imer Sllamnikut! Ne që kemi qenë me Bacën Adem edhe atëherë e sidomos tani jemi pakicë, këta që monument jetësorë e kanë shërbimin ndaj UDB-së dhe kundër interesave kombëtare ishin shumicë. Për fat të keq edhe sot përbëjnë shumicën duke metastazuar në institucionet kryesore të Kosovës, qeveria, ministrinë, presidenca dhe Kuvendi i Kosovës. Hetuesi kryesor kundër ushtarëve shqiptarë që u dënuan në një proces të montuar politik në vitin 1984 para Gjykatës

Ushtarake në Zagreb ishte shqiptar, pjesëtar më herët i UDB-së e pastaj i KOS-it (Shërbimi Kundërzbulues i Ushtrisë Jugosllave) i cili pastaj, pas përfundimit të luftës ishte rehatuar fort mirë në institucionet e Kosovës. Në vitin 1984, pa asnjë dëshmi dhe pa asnjë faj ishin dënuar nga Gjykata Ushtarake në Zabreb: Hysen Shurdhani 12 vjet, Zenel Baçaj 9 vjet, Shefki Barileva 7 vjet, Brahim Mazrekaj 6 vjet, Behxhet Sh. Shala 12 vjet, Isa Jashari 5 vjet, Hysen Zymberi 5 vjet, Fatmir Ahmeti 4 vjet dhe Rexhep Rama (i penduar) 1 vjet. Hatuesi kryesor ishte Enver Krasniqi, epror i KOS-it kurse dëshmitarët që me vullnet dëshmuar kundër të dënuarve ishin, midis tjerëve, Azem Stublla, Muhamet Hoxha dhe Mejdi Selmani.

Të gjithë ne që kemi dënuar i kemi hetuesit tanë, prokurorët tanë, gjykatësit tanë, dëshmitarët tanë që kanë emër dhe mbiemër dhe që nuk kemi dashur t'i bëjmë publikë shkakun se nuk i konsiderojmë të fajshëm pasardhësit e tyre për poshtërsitë e paraardhësve të tyre. Po duhet t'i bëjmë publike sepse edhe për neve mund të thonë se nuk ishim në burgje, se kemi qenë në pushime, se kemi përgjegjësi që ua kemi prishur rehatinë, vëllazërimin – bashkimin dhe bashkëjetesën në Jugosllavinë e Titos. Kur del një i poshtër me mendësi udbashe dhe thotë këtë për Bacën Adem Demaçi e pse atëherë çuditëni për masakrën juridike që po e bën Gjykata Speciale raciste në Hagë kundër Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit, Salih Mustafës, Nasim Haradinajt, Hysni Gucatit dhe Pjetër Shalës... për fillim!

Perëndimi naiv po fle ndërsa fundi i botës po afrohet

Nga Allister HEATH

Ashtu si librat “1984” e George Orwell dhe “Bota e re e guximshme” e Aldous Huxley, del se edhe filmi “Terminator” me protagonist aktorin Arnold Schwarzenegger ishte një plan, dhe jo një vepër fantatiko-shkencore. Kur Skynet, një rrjet kompjuterash i krijuar nga kontraktori ushtarak “Cyberdyne Systems”, u bë i vetëdijshëm, njerëzit në panik u përpoqën ta çaktivizonin atë.

Inteligjenca artificiale e sapoformuar (AI) i identifikoi “të gjithë njerëzit si një kërcënim” dhe nisi një sulm bërthamor ndaj çdo qyteti të madh. Por 4 dekada më vonë, fikcioni rrezikon të bëhet realitet. Në paralajmërimin më rrëqethës që nga peticioni i Szilárd i vitit 1945, dhe nga themelimi nga Albert Einstein i Komitetit të Emergjencës të Shkencëtarëve Atomikë, shumë nga ekspertët më të mirë në botë, janë të bindur se AI mund të shkatërrojë njerëzimin, dhe se kjo teknologji përbën një kërcënim ekzistencial për mbijetesën tonë si specie.

“Zbutja e rrezikut të zhdukjes nga Inteligjenca Artificiale, duhet të jetë një prioritet global krahas rreziqeve të tjera në shkallë shoqërore, si pandemitë dhe lufta bërthamore”, - thuhet ndër të tjera në një letër të nënshkruar nga Sam Altman krijuesi i ChatGPT i kompanisë OpenAI, Demis Hassabis i Google DeepMind dhe shumë të tjerë.

Ekspertë të tjerë të kësaj fushe, kanë braktisur punën e tyre duke shprehur keqardhje për aq sa kanë bërë deri tani. Frika e tyre është më se e dukshme, ashtu siç është edhe ndjenja se këtë herë kemi shkuar shumë larg, se institucionet tona nuk mund ta përballojnë dot situatën, se AI do të rrëmbehet nga mendje të liga për të ndërtuar armë të shkatërrimit në masë apo për të sunduar mbi të gjithë ne.

Të gjithë mund të gabojnë. Inteligjenca Artificiale ka përfitime të mëdha por edhe kosto të konsiderueshme. Atëherë si ka mundësi që kjo çështje nuk është prioriteti numër një i çdo politikani në botë? Si mund t'i besojë dikush se një pakti idiot apo një rregullore formale të BE-së?

Ne përballemi aktualisht me një dilemë të madhe filozofike dhe praktike: Cili është kuptimi i jetës dhe inteligjencës? Si mund të sigurohemi që njerëzimi të mbetet në krye të makinave dhe jo e kundërta? Si mund të balancojmë synimin e rritjes së produktivitetit me rrezikun e asgjësimit nga këto makineri super-inteligjente?

Kjo është padyshim pyetja më

komplekse me të cilën jemi përballur ndonjëherë. E megjithatë shoqëria jonë nuk mundet të përballë me të. Sepse elitat globale kanë gabuar sërish me prioritetet që kanë zgjedhur. Ato janë fokusuar në mënyrë obsesive tek ndryshimi i klimës, duke e kthyer një problem real por të kapërcyeshëm në një fe anti-perëndimore, ndërsa janë çuditërisht të pavëmendshme ndaj kërcënimeve shumë më të mëdha.

Unë nuk po e minimizoj aspak problemin dhe kostot e ndryshimit të klimës. Por e di se ato nuk do t'i japin fund jetës në Tokë, ndryshe nga një luftë bërthamore, luftë biologjike apo një Inteligjencë Artificiale e dalë jashtë kontrollit.

Nxitimi ynë drejt arritjes së zeros emetimeve të gazrave ndotës në atmosferë, duke e reduktuar rritjen ekonomike, po e kufizon në fakt aftësinë tonë për të zhvilluar një përballje me një Kinë që po vazhdon me emetimet e saj të shumta të dioksidit të karbonit. Rreziku më i menjëhershëm për mbijetesën e njerëzimit është lufta bërthamore. Rusia mund të lëshojë ende armë bërthamore taktike ndaj Ukrainës; Kina mund të pushtojë Tajvanin; ose një sulm terrorist mund të zhysë Indinë dhe Pakistanin në një luftë totale midis tyre. Megjithatë, rreziku më urgjent vjen nga përhapja armëve bërthamore, një krizë që përhapet dalëngadalë dhe që bie ndesh me narrativat aktuale, dhe që për pasojë anashkalohet. Koreja e Veriut mbetet një kërcënim i madh, por rreziku i vërtetë është Irani: ai vazhdon të pasurojë uraniumin dhe dëshiron të asgjësojë Izraelin.

Rreziku tjetër i madh është lufta biologjike. Mendoj se është çmenduri që ne vazhdojmë të tolerojmë eksperimentet me viruset dhe modifikimin e tyre gjenetik: në një moment, një virus super i fuqishëm mund të dalë aksidentalisht ose qëllimisht nga një laborator, duke vrarë miliarda njerëz dhe duke e shkatërruar qytetërimin tonë.

Dhe ku është në këtë rast zemërimi dhe parada e aktivistëve të shqetësuar? Inteligjenca Artificiale e dalë jashtë kontrollit, mund të favorizohet nga një patologji në rritje në zemër të shoqërisë perëndimore: varësinë tonë ndaj kolektivit. Në vend se të krijojmë një ushtri individualistësh racionalë dhe elastikë, të pavarur, hiper-edukuar dhe me të gjithë mësimin njerëzor në majë të gishtave, telefonat inteligjentë na kanë reduktuar në një turmë shumë emocionale, shtazarake, dhe të drejtuar nga dopamina.

Sot ka shumë informacione, por pak njohuri. Në vend se të jemi në gjendje të mendojmë vetë, ne



jemi sklevër të modës, jo vetëm kur flitet për veshjen, por edhe për opinionet, konsumin dhe vendimet financiare. Të radikalizuar nga mediat sociale, formuesit e elitës së opinionit, përqafojnë pikëpamjet absurde, dhe e bëjnë këtë me një shpejtësi marramendëse.

Politikanët, bizneset dhe personazhet e famshëm, marrin shkas nga një pararojë revolucionare që po përmbys ndjenjën e përgjegjesisë publike. Shoqëria jonë nuk e kupton më qëllimin e fjalës së lirë, siç e përshkruan John Stuart Mill në esenë e tij “Mbi lirinë”.

Në vend se të angazhohemi në një katekizëm sokratik për të arritur tek e vërteta, ne përdorim fjalë për të sinjalizuar virtytin dhe për të fshehur emocionet bazë. Elitat tona pretendojnë se janë humanistë universalistë. Në fakt ato janë tribalistë të rilindur, të cilët e kalojnë kohën e tyre duke u vendosur përballë grupeve të jashtme (cilido që nuk është dakord me ta).

Ne nuk po dimë të mendojmë më në një mënyrë kritike. Subjektiviteti dhe nihilizmi sundojnë në mënyrë

absolute: kulti i çmendur dhe post-modernist i lëvizjes “Woke”, pretendon se nuk ka më të vërteta universale, por vetëm të vërteta tona.

Idetë janë në rastin më të mirë të mira pozicionale, pra deklarata që janë në modë, shënjuese të hierarkisë sociale, dhe në rastin më të keq mjete shtypjeje. Fjalët nuk kanë më asnjë kuptim thelbësor: shprehja e “mendimit të drejtë” sinjalizon një status të lartë (edhe nëse opinioni është i pakuptimtë, siç është pretendimi se Kina nuk kishte asnjë lidhje me Covid-in) dhe “të menduarit e gabuar” (siç është mbështetja për Brexit) nënkupton një status të ulët.

Alex Tabarrok i George Mason University, argumenton se shoqëria jonë nuk është thjesht gjithnjë e më kapriçioze, por edhe e prirur ndaj një çmendurie të re të turmave. Duke e rritur transparencën dhe duke ulur kostot e transaksionit, teknologjia ka “intensifikuar çmendurinë e masave dhe ka zgjeruar shtrirjen e tyre, nga financat te politika dhe kultura, asnjë fushë nuk mbetet e paprekur”.

Paniku bankar është gjithnjë e më

i shpejtë, ku depozitat zhvendosen nga llogaritë online sapo fillojnë të qarkullojnë disa zëra alarmantë. Lajmet e rreme, bojkotet, zemërimi, demonstratat, paniku shëndetësor dhe thirrjet për falimentim të bankave po bëhen një normë. Nuk ka asnjë mekanizëm për korrigjimin e gabimeve. Një botë – e qeverisur nga parimet e kundërta me ato të zhvilluara nga Nassim Nicholas Taleb në librin “Antifragile” – është e ndjeshme ndaj manipulimit, dhe rrjedhimisht ndaj përdorimit si një armë e Inteligjencës Artificiale.

Imagjinoni një video të falsifikuar në mënyrë të rafinuar (deepfake) të parë 20 milionë herë brenda pak orësh, që paralajmëron për një sulm të afërt terrorist, apo që “provon” se një politikan ishte një mashtrues disa orë përpara zgjedhjeve: ndikimi do të ishte katastrofik. “A mund t'i mbijetojmë teknologjisë?” - pyeti në vitin 1955 John von Neumann, mendja më e madhe e shekullit XX-të. A mund të jetë vërtet negative përgjigja? / Daily Telegraph – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Duro zëvendëson Ramadanin te Gjilani

GJILAN, 26 QERSHOR - Klodian Duro do ta pasojë Zekirija Ramadanin te SC Gjilani. Trajneri shqiptar do ta marrë në dorë ekipin e Kosovës, i cili do ta

zyrtarizojë shumë shpejt marrëveshjen. Kryetari i klubit gjilanas, Florim Zuka, ka arritur marrëveshje me ish-trajnerin e Feronikelit, i cili do të rikthehet

kështu në futbollin e Kosovës. Me Duron, Gjilani do të luajë në garat evropiane, respektivisht në Ligën e Konferencës. Ish-përfaqësuesi shqiptar synon ta

çojë përpara klubin nga Anamorava. Së fundmi, Gjilani u nda me trajnerin Zekirija Ramadani, i cili mori ofertë nga Arabia Saudite.



Gashi lë Gjermaninë, konfirmon rikthimin në futbollin e Kosovës

Fatlum Gashi ishte larguar nga Kosova për ta vazhduar karrierën në Gjermani, por pas një vit ai do të rikthehet. "Lumi" kishte marrëveshje dhe këto ditë do të bëhej pjesë e Lippstadt 08, por për arsye familjare ai do të rikthehet për ta vazhduar jetën në vendlindje

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 QERSHOR - Fatlum Gashi është një futbollist i respektuar e i dëshmuar në futbollin e Kosovës. "Lumi" një vit më parë vendosi ta braktisë futbollin dhe Kosovën për ta vazhduar jetën e karrierën në Gjermani, ku për tetë muaj ishte aktiv në futbollin gjerman në rangje më të ulëta. Gashi ishte afër marrëveshjes me SV Lippstadt 08 që bën gara në Regionalliga West apo ligën e katërt gjermane, por për shkaqe personale nuk do të shkruajë marrëveshje me këtë klub dhe do të rikthehet në Kosovë. "Këto ditë kam pasur mundësinë të nënshkruaj kontratë me SV Lippstadt 08, por për arsye familjare më duhet të kthehem në Kosovë dhe nuk mund ta vazhdoj karrierën në Gjermani", ka thënë Gashi për "Epokën e re". Futbollisti Gashi me rikthimin në Kosovë do t'i rikthehet edhe

futbollit të Kosovës në të cilin ka një karrierë të gjatë, ku ka luajtur për klube si Besa e Pejës, Dukagjini, Istogu e Drenica. "Menjëherë si të kthehem do të nënshkruaj me një klub dhe të vazhdoj të luaj, sepse e dua futbollin. Tashmë kam marrë disa oferta dhe brenda pak ditësh do të vendos për ofertën më të mirë", ka shtuar ai. "Lumi", që është vëllai i mesfushorit të njohur Dukagjin Gashi, nuk ka pranuar t'i tregojë emrat e klubeve të cilat e kanë kontaktuar. "Jo, nuk është korrekte të përmend emra tash për tash, por mund të konfirmoj se dy oferta janë nga klubet e Superligës e dy të tjera nga Liga e Parë", ka konfirmuar Gashi. Edicionin e fundit para se të largohet nga futbollin e Kosovës, Gashi ishte pjesë e rëndësishme e skuadrës së Drenicës. Atëkohë ishte zgjedhur edhe futbollist i javës për paraqitjen brilante që kishte në ndeshjen ndaj Dritës së Gjilanit (2-1).

Jashari ndahet me Lirinë

Mbrojtësi i spikatur në futbollin e Kosovës, Dardan Jashari, është larguar nga skuadra e Lirisë së Prizrenit. Në "Facebook" ai ka njoftuar se largohet nga klubi me të cilin arriti të inkuadrohet në Superligën e futbollit. "Faleminderit Liria, faleminderit Prizren, faleminderit 'Arpaxhikët'! Ju njoftoj se nuk do të jem pjesë e skuadrës së Lirisë, skuadër kjo ku kalova gjashtë muaj, duke arritur suksesin e madh të ngjitjes në Superligë. Ishin gjashtë muaj të mrekullueshëm, andaj dua t'i falënderoj drejtuesit e klubit, trajnerin dhe shtabin teknik me të cilin bashkëpunuam, tifozët e mrekullueshëm 'Arpaxhikët' që ju ishit më meritoret për arritjen e gjithë këtij suksesi si dhe gjithë qytetin e Prizrenit për mbështetjen e tyre. Suksese tutje klubit FC Lira!", ka shkruar Jashari.



Donjeta Sadiku kualifikohet në çerekfinale, Bajoku përfundon garat në Lojërat Evropiane



PRISHTINË, 26 QERSHOR - Boksierja Donjeta Sadiku ka kaluar edhe pengesën e dytë në garat e boksit në Lojërat Evropiane "Krakow 2023". Boksierja e Kosovës ishte bindshëm më e mirë se zvicerania Anna Jeni, kategoria -60 kg. Sadiku u kualifikua në çerekfinale dhe tani është një fitore larg sigurimit të medaljes dhe normës olimpike. Meçin e saj

nga afër e ndoqi edhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi. Ndërsa boksieri i Kosovës, Bashkim Bajoku, ka garuar sot në 1/16 e finales së garave të boksit në Lojërat Evropiane "Krakow 2023". Boksieri Bajoku ishte i pafat, pasi përballë kishte francezin Bilall Benama, nënkampion botë dhe kampion i Evropës, kategoria -51 kg, ndaj të cilit dha maksimumin, por që

përvoja e francezit e bëri të vetën. Bajoku përfundon në vendin e nëntë të kategorisë së tij në Lojërat Evropiane. Të hënën garat i përfundoi edhe Edi Dvorani. Shigjetari ynë u ndal në 1/32 e finales, disiplina hark olimpik. Ai pësoi humbje nga slloveni Habjan Malavashiq. Komiteti Olimpik i Kosovës i ka urrear Edit më shumë fat në garat e ardhshme ndërkombëtare.

Phoenixi angazhon në stafin teknik Mc Kreshën

BANJË, 26 QERSHOR - Mc Kresha është paraqitur nga skuadra e Ligës së Parë, Phoenix, si pjesë e stafit teknik dhe menaxher gjeneral i klubit. Këngëtarin nga

Mitrovica e pranoi këtë pozitë dhe drejtuesit e klubit mezi presin që ai ta nisë punën në bashkëpunim me trajnerin Gani Sejdiu. "Me kënaqësi ju

njoftojmë se Mc Kresha ka pranuar të bashkohet me Klubin e Futbollit Phoenix si pjesë e stafit teknik dhe menaxher gjeneral. E

falënderojmë dhe na nderon për bashkëpunimin e tij me trajnerin Gani Sejdiu. Zyrtarizimi bëhet në ditët në vijim", thuhet në njoftimin e Phoenixit.



Shillova dhe Hajdari largohen nga Malisheva

MALISHEVË, 26 QERSHOR - Dy futbollistët e njohur, Alban Shillova dhe Fiton Hajdari, janë larguar edhe zyrtarisht nga skuadra e Malishevës. “Nga sot nuk jam pjesë e Klubit FC Malisheva. Falënderoj kryesinë

e klubit, stafin teknik, bashkëlojtarët dhe të gjithë tifozët e klubit! Suksese tutje!”, ka thënë Shillova në njoftimin për largimin nga klubi i Superligës. Ndarjen me Hajdarin e ka


konfirmuar vetë skuadra e Malishevës: “FC Malisheva dhe sulmuesi Fiton Hajdari e kanë ndërprerë bashkëpunimin pasi që lojtarit i ka përfunduar kontrata. Fitoni pati një sezon të suksesshëm me skuadrën

tonë e sidomos në stinorin pranveror. Kontributi i tij ishte i paçmueshëm. E falënderojmë Fitonin për kontributin e dhënë për ekipin dhe i dëshirojmë suksese të shumta në karrierë dhe jetë”.



Gundogan: Dua ta ndihmoj Barçën të kthehet atje ku e meriton

BARCELONË, 26 QERSHOR - Ilkay Gundogan edhe zyrtarisht është lojtar i Barcelonës. Lajmin e ka dhënë klubi spanjoll në “Twitter”, ku i ka uruar mirëseardhje mesfushorit gjerman. Gundogan u largua nga Manchester City në drejtim të katalanasve dhe do të jetë i lidhur me një kontratë deri në vitin 2025. “Nëse do të largohesha, kishte vetëm një klub në botë ku kishte kuptim të shkoja. Ishte Barcelona ose asgjë. Që kur isha i vogël, ëndërroja ta veshja atë fanellë një ditë. Kam besim se më kanë mbetur edhe pak vjet në nivelin më të lartë dhe thjesht dua ta ndihmoj Barcelonën të kthehet atje ku meriton të jetë. Do të jetë një ribashkim me mikun tim të vjetër Lewa. Jam i emocionuar për të luajtur me një trajner tjetër, të cilin e kam admiruar për një kohë të gjatë. Kur unë dhe Xavi folëm për projektin, m'u duk shumë e natyrshme. Unë shoh shumë ngjashmëri mes nesh si futbollistë dhe në mënyrën se si e shohim lojën”, ka thënë Gundogan. “Unë e di se do të ketë shumë presion në Barcelonë. Por unë e dua presionin. Më pëlqen të dal nga zona ime e rehatisë. Nuk po kërkoja një ulje të lehtë. Po kërkoja një sfidë të re. Kjo është



për çfarë bëhet fjalë ky kapitull tjetër. Mezi pres të luaj me fanellën e Barcelonës”, ka shtuar Gundogan. 32-vjeçari i bashkohet Barcelonës si futbollist i lirë pasi i përfundoi kontrata aktuale me Manchester Cityn.

Verstappeni: Ky sezon po më mërzi edhe mua pa rivalitet



MILTON KEYNES, 26 QERSHOR - Po dominon me shumë lehtësi në sezonin 2023 të Formulës 1, ndaj piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, shprehet se bën tifo për skuadrat e tjera, në mënyrë që të rivalizojnë më shumë. “Ndonjëherë është e bukur kur ka rivalitet në pistë”, u shpreh holandez, dy herë kampion bote. “Viti 2021 më pëlqeu shumë, por edhe viti i kaluar për mënyrën se si shkuan gjërat. E nisëm keq

sezonin, por makina më pas ishte dominuese në pistë. E kuptoj që këtë vit njerëzit po mërzi duke parë garat e Formula 1, por kjo gjë ka ndodhur edhe më parë me Mercedes, Ferrari apo edhe me vetë Red Bullin”, ka thënë holandez. “Shpresoj që sa më shumë skuadra të marrin pjesë aq më shumë të rritet konkurrenca. Kështu, nëse ke një problem dhe nuk arrin të kesh një makinë të shpejtë, është një makinë tjetër

që mund të fitojë”, ka shtuar Verstappen. “Dominimi ynë është për shkak të punës së madhe që kemi bërë. Edhe ne e vlerësojmë atë që bënte Mercedesi disa vjet më parë kur dominonte. Është thjesht çështje pune dhe të përpiqesh të rikuperosh. Unë jam i motivuar dhe kam një makinë fituese. Ndoshta të tjerët nuk janë aq të motivuar sa unë”, u shpreh Verstappen.

SHKURT

Pllana konfirmon ndarjen me Prishtinën

Bujar Pllana është ndarë edhe zyrtarisht me Prishtinën. Lajmin e ka konfirmuar futbollisti në “Facebook”. “Nuk do të jem pjesë e FC Prishtina. Falënderoj kryesinë, trajnerët, bashkëlojtarët si dhe të gjithë stafin! Gjithashtu, falënderoj tifozët ‘Plisat’ për përkrahjen e dhënë, kurse klubit i dëshiroj shumë suksese në të ardhmen”, ka shkruar Pllana.

Modriqi vazhdon kontratën me Realin

Mesfushori veteran Luka Modriq ka vazhduar kontratën me Real Madridin. Reprerentuesi kroat me kontratën e re do të jetë pjesë e “mbretërve” deri më 30 qershor të vitit të ardhshëm. Lajmin e ka bërë me dije klubi mbretëror përmes një komunikate të lëshuar në faqen zyrtare. “Real Madrid CF dhe Luka Modriq kanë rënë dakord për ta vazhduar kontratën e lojtarit, i cili mbetet i lidhur me klubin deri më 30 qershor 2024”, thuhet në komunikatë. Modriqi iu bashkua Real Madridit në vitin 2012 kur u transferua nga Tottenham Hotspuri.

Allegri refuzon ofertën e Al-Hilalit

Massimiliano Allegri nuk po e mendon largimin nga Juventus. Gazetari i njohur Fabrizio Romano ka raportuar se trajneri italian e ka refuzuar ofertën e Al-Hilalit. Klubi nga Arabia Saudite i kishte ofruar kontratë dyvjeçare dhe pagë prej 20 milionë eurosh në vit. Megjithatë, as kjo ofertë nuk e ka bindur Allegrin të largohet nga “Zonja e Vjetër”. 55-vjeçari thuhet se nuk ka qenë asnjëherë në kontakt me Al-Nassrin dhe se i vetmi klub që i bëri ofertë ishte Al-Hilali. Trajneri italian është i fokusuar vetëm te Juventus dhe kjo është arsyeja pse ai refuzoi ofertën. Ndryshe, Massimiliano Allegri me klubin nga Torino ka kontratë të vlefshme deri më 30 qershor 2025.

Unitedi synon transferimin e Onanas

Manchester Unitedi po synon të luftojë për titull në Premier Ligë dhe përforcimet pritet të jenë të shumta. Trajneri Eric Ten Haag e dëshiron portierin e Interit, Andre Onana, pasi ka punuar sa ishin pjesë e Ajaxit. Klubi italian i dëshiron 60 milionë euro por kamerunasin që e transferoi me parametra zero. Mirëpo Unitedi pritet të ofrojë një shumë më të ulët sesa kjo që kërkohet nga nënkampionët e Evropës.

PSG-ja ofron 35 milionë për Hernandezin, Bayerni i kërkon 50 milionë

Lucas Hernandez ende nuk dihet nëse do të qëndrojë në Bayern Muncheni apo të largohet. Dëshira e lojtarit francez është të largohet nga “Allianz Arena” pas katër vjetëve qëndrim. Hernandezi ka arritur marrëveshje personale me kampionin në fuqi të Francës, Paris Saint Germain, për një kontratë pesëvjeçare nga e cila do të fitojë 15 milionë euro në sezon. 27-vjeçari po i bën presion Bayernit për mos ta penguar që të rikthehet në Francë. “Sky Sport” ka raportuar se PSG-ja tani po mendon të bëjë një ofertë në drejtim të Bayernit për francezin kontrata e të cilit skadon pas 12 muajve. PSG-ja synon të ofrojë rreth 35 milionë euro, derisa Bayerni insiston të fitojë 50 milionë euro nga shitja e tij.



e-mail: eling.pr@gmail.com
Adresë: Muharrem Feja Cjg, Lok.1-1

MOB: +383 (0) 44 433 467
+383 (0) 44 727 913
Tel-Fax: +381 (0) 38 548 016

Prishtinë, 24/06/2023

NJOFTIM PUBLIK

Shoqëria "ELING GRUP" SH.P.K., me numër Unik Identifikues 811484021 me adresë: Rruga Muharrem Feja, Obj. 1 Lok.1 Prishtinë, Republika e Kosovës, në përputhje me dispozitat e Nenit 13 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, me datë 21.03.2023 ka dorëzuar në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE) aplikacionin për marrje të Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga panelet solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Llabjan, Komuna e Pejës, Republika e Kosovës.

Shoqëria „ELING GRUP“ SH.P.K., për projektin solar me kapacitet të instaluar prej 1 MW ZK Llabjan, Komuna e Pejës, me rastin e aplikimit, ka dorëzuar në ZRRE dëshmitë për marrje të AUTORIZIMIT siç janë:

- Pëlqimin Nr. 08-350-126761 dt. 22.12.2022 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës;
- Pëlqimin Mjedisor Nr.22/50/ dt.02.03.2023 të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruturës;
- Vendimin për Kushte Ndërtimore për vendosjen e paneleve për energji solare me kapacitet të instaluar prej 1 MW Nr. VIII> -350-10734 dt. 08.02.2023t të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës;
- Vendimin për Leje Ndërtimi për "Vendosjen e Paneleve për Energji Solare prej 1 MW ZK – Llabjan Komuna e Pejës" nr. i vrojtimit të lejes 08-351-24941 dt. 17.03.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Pejës;
- Aktvendimin Nr. 330/23 dt. 02.03.2023 të lëshuar nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonimi e Komës së Pejës;
- Pëlqimin Elektroenergjetik Nr. 3582 dt. 28.04.2023 të lëshuar nga KEDS SH.A.;
- Dëshmi mbi të drejtat pronësore (Kontratrat për shfrytëzimin e tokës);
- Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar;
- Plani i Biznesit; dhe
- Plani Dinamik i Realizimit.

Aplikuesi ka dorëzuar edhe kërkesat administrative sipas aplikacionit dhe ka dorëzuar kërkesën që, energjia e prodhuar nga ky projekt do të shitet bazuar në çmimet e tregut.

Njoftohen të gjitha palët e interesuara që vërejtjet e tyre eventuale lidhur me këtë aplikacion, mund të paraqesin në ZRRE brenda 8 (tetë) ditësh nga data e publikimit të këtij njoftimi në adresën elektronike: eling.pr@gmail.com dhe LEGAL-LECSING@ero-ks.org

Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për aq sa e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "HB Pure Beauty" Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811858771 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da društvo sa "HB Pure Beauty" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrB: 811858771 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "HB Pure Beauty" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811858771 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fëllënze Dula nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl I,II,III,IV të shf.m. "Hysni Zajmi".

Vëllaznim Rraci nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Daut Husi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

Altin Kamberi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Nexhat Mehollj, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "TREPCA"

Leutrim Shehi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren

Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollëshme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollëshme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

